



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL -MALISHEVË/QKMF "Dr. SHPËTIM ROBAJ" NË MALISHEVË
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, të nenit 8 të Ligjit të Punës nr: 03/L-212, në bazë të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 si dhe në bazë të Statutit të QKMF-së nenit 10. Drejtori Dr Afrim Krasniqi shpall:

KONKURS INTERN (I MBREDSHËM) PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS.

Pozita: Teknik i Radiologjisë në QKMF.

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave	(1) Një.
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i QKMF-së
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese	6 (Gjashtë) muaj

Kushtet e veçanta të Konkursit:

- Shkollën e Mesme të Mjekësisë
- Licencën Teknik i Radiologjisë.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Detyrat e Punës:

- Pranon pacientët për shërbimet radiologjike, kontrollon rregullsinë e udhëzimit mjekësor, protokollon dhe evidenton të dhënat e pacientit, cakton terminin për ekzaminim;
- Kryen të gjitha procedurat e nevojshme të përgatitjes dhe pozicionimit të pacientit me qëllim të ekzaminimit;

- Përgatit aparaturën për ekzaminime dhe realizon ato sipas udhëzimeve të mjekut radiolog, konsulton Radiologun për kualitetin e incizimit dhe cilësinë për të cilën edhe mbanë përgjegjësi;
- Është përgjegjës për mjetet e punës si: kasetat, foliet, filmat, zhvilluesit, komorën automatike, racionalizimin e përdorimit të tyre dhe materialit shpenzues si dhe mirëmbajtjes së aparaturës në përgjithësi;
- Është përgjegjës për cilësinë teknike të ekzaminimit radiologjik,
- Kujdeset për konfidencialitetin e pacientit;
- Është i obliguar të bartë dozimetrit personal dhe mjetet mbrojtëse të punës,
- Respekton normat dhe kodin e veshjes në përputhje me Rregulloren në fuqi;
- Kryen edhe punë të tjera nga lëmia profesionale.

Përgjegjësitë:

Sipas Ligjit të Punës dhe Ligjit për Shëndetësi si dhe Udhëzimeve Administrative dhe Rregulloreve në Fuqi.

Dokumentet e nevojshme:

- Diploma dhe kualifikimet përkatëse.
- Licencën e punës
- Formulari i aplikimit i plotësuar
- Rezumeja personale (CV)
- Letërnjoftimin të fotokopjuar .
- Përvoja e punës (së paku 3 tri vite)

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen në rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 8 ditë, aplikacionet dorëzohen nga **data: 15.04.2022 deri me dt: 22.04.2022** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e personelit në QKMF (ditëve të punës prej: 07 deri ora 15).

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

QKMF-Malisheve

Dt: 16.03.2022

Drejtori:

Dr. Afrim Krasniqi. Spc. Mjek Familjar

